

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria **Saudi Aramko Development Kompani**, me seli të regjistruar në kutinë postare 5000, Dahrana, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite, dhe **Eksel Investments Holandia B.V.**, me seli të regjistruar në P. De Kubertinveg 7 N6225XT, Maastricht, Holandë, përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 23.06.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse të zinxhirit të furnizimit për sektorin industrial në Arabinë Saudite nga **Saudi Aramko Development Kompani** (Saudi Aramco Development Company), me seli të regjistruar në kutinë postare 5000, Dahrana, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite, dhe **Eksel Investments Holandia B.V.** (Exel Investments Netherlands B.V.), me seli të regjistruar në P. De Kubertinveg 7 N6225XT, Maastricht, Holandë, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 12.05.2023, plotësuar më 05.06.2023 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **Saudi Aramko Development Kompani**, me seli të regjistruar në kutinë postare 5000, Dahrana, 31311, Mbretëria e Arabisë Saudite, dhe **Eksel Investments Holandia B.V.**, me seli të regjistruar në P. De Kubertinveg 7 N6225XT, Maastricht, Holandë që i referohet formimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Saudi Aramco Development Kompani është shoqëri e varur në pronësi të plotë të Saudi Arabian Oil Kompani (Saudi Arabian Oil Company; „Saudi Арамко“). Saudi Aramco është i angazhuar kryesisht me kërkime gjeologjike, shpimin dhe nxjerrjen e substancave të hidrokarbureve dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe marketingun e këtyre substancave.

Saudi Aramco nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Eksel Investments Holandia B.V (Exel Investments Netherlands B.V.), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila nuk është e listuar në bursë, e themeluar sipas ligjeve të Holandës dhe është një shoqëri e varur në pronësi të plotë indirekte të Dojçe Post AG (Deutsche Post AG).

Dojçe Post AG është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj të varur të DHL EKSPRESS MACEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 32 nr. 5 Ilinden, me aktivitet kryesor të regjistruar - Veprimtari për ofrimin e shërbimeve të tjera postare dhe të korrierit. Shërbimet e ofruara në Maqedoninë e Veriut përfshijnë menaxhimin e dërgesave, si dhe shërbimet postare dhe të korrierit.

Sipërmarrja e përbashkët do të themelohet në Arabinë Saudite dhe do të jetë aktive në zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për të ofruar shërbime të prokurimit dhe logjistikës në Arabinë Saudite dhe në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Aktualisht, nuk është paraparë që Sipërmarrja e përbashkët nuk pritet të ofrojë shërbimet e veta në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски